



**Do të jem kryetari i parë i Kosovës së pavarur që nuk do të marrë gjë nga ajo”, thotë Pacolli.**

Ndërmarsi ndërtimor nga Zvicra paralajmëron se do të kandidojë për kryetar të Kosovës dhe do të vendosë sistem presidencial. Shqiptari më i pasur në botë ,siç e paraqesin mediat ndërmarrëse ndërtimor nga Zvicra , Behxhet Pacolli, në intervistën e gazetës “Globus” të numrit të djeshëm shfaq dëshirën të bëhet kryetar i Kosovës së pavarur. Në intervistën me titull “Miliarderi që do të blej Kosovën ” Pacolli thotë “Kam fituar mjaft që të realizoj ëndrrën për Kosovën e pavarur , do të bëhem kryetar i saj i parë që do të jap për të e nuk do të marr nga ajo”.Për këtë qëllim si dhe për lobimin e Pavarsis së Kosovës , ai ka angazhuar firmën lobuese “Xhonsen dhe Votermen “ e cila në vitin 1991 ka lobuar për njohjen e pavarsisë së Kroacisë Pacolli ka formuar edhe partinë Aleanca për Kosovën e re , në të cilën siç thotë janë anëtarësuar rreth 50 mijë qytetarë.

Në rrethana tashmë politike në Kosovë nuk është i kënaqur,dhe për këtë thotë “Pushtetarët e Kosovës për fat të keq kanë humbur lidhjet me popullin e në veçanti me të rinjtë , të cilët si fuqi punëtore janë burimi më i madh i yni.

Qeveria merret më shumë me vetveten e vet e pak me ekonomi.

Pacolli ka edhe qëndrime interesante lidhur me demokracinë , të cilën e mendon dhe dëshiron në Kosovë .” Kosovës i mungon udhëheqja sepse me traditën e saj gjithmonë ka qenë një burrë që ka qenë kreu i familjes .

Në shtëpinë ku ka zotë shtëpië të fuqishëm ç’do gjë funksionon si duhet e ku nuk është ai ç’do gjë është kaos.

Ky sistem parlamentar në Kosovës nuk mund të qëndroj.

Për këtë qëllim Pacolli paralajmëron se do të përqipet për zgjedhjen presidenciale në Kosovë dhe për zgjedhjet e tilla që ai do të ketë pushtetin më të madh:”Pohoj se duhet futur sistemin presidencial me të cilin kryetari i shtetit mund të ndërroj edhe kryetarë të komunave e kryeministrin e edhe të shpërndaj parlamentin.

Unë me siguri nuk do të pranoj koalicionin me as një parti. Nëse partia ime ushtron pushtetin duhet të zër të paktën 50 % të votave. Nëse e marrë shumicën do të propozoj nxjerrjen e kushtetutës së re me të cilën ekipi ndërkombëtar po punon intensivisht,sipas së cilës kryetari do të ketë pushtetin më të madh.

Pacolli ka edhe disa risi të tjera: “Përqipem të suspendoj statusin e minoritetit ndërkombëtar ,sepse ky termin më tingëllon si komunist dhe konsideroj se në Kosovë të gjithë pa marr parasysh përkatësinë kombëtare duhet të ndjehen si qytetar të rendit të parë”.